

PYJET E RINGJALLURA TE DUMRESE – NE UDHEN NGA SHKRETIRA DREJT PARKUT

Nga Haki KOLA

Lavdia dhe bukuria e dushkajave te Dumrese filloi te humbase pas viteve 1960, ndersa ne periudhen 1991-1996 ato ishin bere rrafsh me token duke u kthyer ne shkretetire, ku nuk kishte hije as per breshken e hardhucen. Ne vend te lisave gjigandw te Dumrese, qe pleqte kujtojne kur kater burra nuk zaptonin dot trungun e njerit prej tyre, mbeti nje shkretetire ku dukeshin rralle rralle disa driza e presh gjarperi, dele te shperndara ne kerkim te ndonje fije te rralle bari apo siluetat e disa banoreve qe tentonin te shkulinin ato pak rrenje te lisave te mbetura nen toke. Liqenet filluan te thahen e tokat bujqesore te mbeteshin djerre. Pyllit po i humbte nami e nishani. Madheshtia dhe bukuria e propozuar nga Sami Frasheri mese nje shekull me pare per kryeqytet te Shqiptareve, kishte mbetur e cveshur ne mes te ererave e zhegut. Liqenet po ktheheshin ne keneteza te baltosura dhe pluhuri i mbetur pas nga makinat ngarkuara me plackat e te ikurve drejt qyteteve i shtonin edhe me teper shkretimin vendit.

Ne te tilla kushte filloi projekti i pare pilot i pyjeve komunale, projekt i financuar nga Banka Boterore e Qeveria Shqiptare, per te eksperimentuar rehabilitimin e pyjeve me pjesmarrje te komunitetit, qe filloi te pergatitet si pilot ne gusht 1994 e te zbatohet ne vitet 1997-2008. Pas konsultave te vazhdueshme me banoret, filloi puna per sensibilizimin e komunitetit, ngritjen e komisioneve per pyjet e kullotat ne cdo fshat, si dhe me nje bashkepunim te ngushte me teknikun veteran te pyjeve Tomorr Shehu e ambientalistin e njohur te Elbasanit Ahmet Mehmeti, diagostikimin e gjendjes si dhe identifikimin e nevojave te permiresimit te pyjeve me prerje riparteritese e pyllezime. Pas hartimit te planeve dhe zbatimit te disa nderhyrjeve te rendesishme silvikulturore, me kualitet te larte, frut i punes se apasionuar te banoreve e personelit pyjor duke realizuar nderhyrje te thjeshta ne mbi 600 hektar territor pothuaj te abandonuar shoqeruar me nje pune te madhe sensibilizuese e ndergjegjesuese, te kryer nga Shoqata e Perdorimit te Pyjeve dhe Kullotave Komunale, qe bashkepunoi ne menyre intensive me komunat DSHP-ne Elbasan dhe Njesine e Menaxhimit te Projektit te Pyjeve. Frut i kesaj pune ishte ndergjegjesimi per te mos kullotur pyllin e ri e ulja e numrit te dhive ne minimum, si faktor i rendesishem per menjanimin e mbikullotes ne kete vend te kthyer ne shkretetire, ku katermebdhjetë vite me pas (qe nga vizita e pare ne gusht 1994 e deri ne ate te 17 gushtit 2008) shkretetira eshte shendrruar ne nje pyll real te dendur ku lisat plot shendet e kane kaluar lartesine 5-6 m, po kthehen shpendet dhe kafshet e egra qe zbukurojne natyren dhe shendoshin mjedisin, pylli i Dumrese po fiton gradualisht edhe egersine e autoritetin e pyllit.

Lumturiu ish kryetar i komunes ne kulmin e perpjekjeve antishkretuese e aktualisht punonjes i administrates se komunes, ankohet pasi nje nate para dy vjetesh jane ekzekutuar dy ujqer, te cilet duket se kane harruar reflekset e parardhesve te tyre me tendencen per tu futur deri ne oborret e fshatareve. Lumturiu ankohet per ujqerit e vrare, ndersa te tjera nderhyjne e tregojne shume dele e disa kafshe ngarkese jane asgjesuar nga ujqerit kete vit. Dhelprat jane shtuar e sulmojne edhe tufat me gjela deti. Lepujve nuk u mjafton vetem pylli por here here hidhen edhe ne jonxha. Ne e duam ujkun por ndoshta

edhe fondacionet qe mbeshtesin shtimin e tyre duhet te shperblejne fshataret e demtuar thote Qemali, kryetar i Komunes. Pyllin do ta shpallim park te komunes, pasi ai i sherben gjithë zones se Myzeqese, REC po na mbeshtet me nje projekt, dhe diskutimet e para i kemi bere ne Keshillin e Komunes, vazhdon me entuziazem kryetari.

Pylli i Banushit, me te drejten qe i jep te qenet i pari pyll i zones frut i kembenguljes se Banushit, ka marre tashme pamjen autoritetin dhe egersine e nje pylli te vertete. Nuk eshte cudi qe aty te jene edhe ariu e derri, pasi me pamjen e xhungles ai duket sikur u siguron atyre vec strehimit edhe ushqimin e domosdoshem. Nuk mbeten pas pyllit te lisit edhe pyllzimet e bera me akacie e plep, dafinat e bregliqenit duken te gjalleruara e me te rritura. Ata sikur te kujtojne se ne idene e ngulitur tek banoret per ta kthyer pyllin e Dumrese ne nje park te madh, Ilqja e Dafina behen te rendesishme qe te shtohen ne anet e pyllit gjigand te dushkut gjethe renes, per te zbkuruar vendin gjate periudhes se dimrit kur dushkut i bien gjethet, e pejsazhi tenton te behet i kafejte.

Ndersa behet bilanci i vitit 2007 cilesuar si vitit i djegieve, ku u dogjen pyje ne mbare vendin, Lumturiu thote se nese digjet pylli thote ne duhet te ikim qe ketu, rikthimi i pyjeve nuk eshte nje fjale goje, por eshte problem ekzistence. Pylli po i rikthen lavdine Dumrese, por jovetem ate, ai po rikthen gradualisht edhe ekonomine. Ne jemi afer Elbasanit e Tiranes, rreth 900 hektar pyje te ringritura bashke me liqenet i kane hijeshuar kodrinat midis Devollit e Shkumbinit dhe po i japin pamjen e nje zone turistike. Jo vetem nga Elbasani e Belshi por edhe nga te tjera zona vijne vazhdimisht vizitor qe duken ne rritje.

Kjo po shton interesin e fshatareve per te shtuar vreshtat, ullirin e pemet e tjera, por edhe per te permiresuar cilesine e veres. Aq e kerkuar eshte vera apo e djathi kackavall saqe ato shiten pa e kaluar territorin e komunes. Thatesira sivjet ka thare qe tani ne gusht te gjithë misrat, te cilat duken si kallamishta ku kane kaluar zjarre. Po ulliri e vreshti e dushku, jeshilojne e pasurojne pejsazhin.

Brenda nje hapësire kohore 14 vjecare shkretetira e Dumrese eshte tashme nje shkolle per te luftuar shkretimin dhe duhet bere e tille per trajtimin e pyjeve te dushkut. Ajo eshte vizituar nga dhjetra eksperte te huaj, si simbol i ndryshimit te paparashikueshem. Me potencen qe ka arritur akumulon per cdo vit mbi 20 mije ton gaz karbonik, duke dhene nje kontribut modest ne parandalimin e ndryshimeve klimatike, per Shqiperine e Globin. Qe nga viti 2003 eshte ngritur nje eksperiment per trajtimin e cungishteve te Dushkut, me objektiv perdorimin e qendrueshme te cungishteve, duke realizuar shendrrimin e tyre ne perspektive ne pyje te larte, duke realizuar krahas funksionit prodhues edhe ate rekreativ e mjedisor per zonen me te thate dhe me te nxehte te Shqiperise.

Nga matjet e realizuara ne vitin 2003, rezultonte nje rritje vjetore prej 7 m3 per hektare, rreth 5 here me e madhe se rritja mesatare ne shkalle vendi, thote nje nder autoret, Jani Male, aktualisht konsulent per pyjet komunale i SNV (organizata hollandeze per zhvillim). Duke debatuar me pylltarin me pervoje te Shoqates se Grekanit zotin Isuf Salla, zbatues i projektit, argumenton qe eksperimentet e ngritura deshmojne per potencial me te larte prodhues te ketyre pyjeve, si dhe mundesi per te inicuar nga Dumreja ndryshime rrenjesore ne trajtimin e pyjeve te dushkut ne gjithë vendin, nje burim i rendesishem per bionergjine, silvopastoralizmin, apo rekreacionin e popullsisë,

me pak fjale te permiresuar jetesen ne keto zona te thata rurale. Jakovi, koordinatori aktual i projektit te zhvillimit te burimeve natyrore, se bashku me inxh Isufin i perseriten matjet e eksperimenteve ne vitin 2008 si dhe bene albumin me fotografi qe eshte bashkengjitur. Ne disa nga variantet rritja eshte dyfishuar krahasuar me deshmuesin. Duken te pafundme alternativat per ta trajtuar e perfituar si pylli ashtu edhe komuniteti.

Ne krizen e dukshme energjitike me te cilen po ndeshet mbare njerezimi, Dumreja na tregon nje model per te trajtuar mbi 200-300 mije hektare toka ne te gjithe vendin, por vecanerisht na meson se cfare potenciali kane kodrat e mrekuellueshme te Tiranes, Durresit, Kavajes, Peqinit, Lezhes, Mallakastres e shumices se rretheve te jugut te vendit tone. Dumreja na e krijoi modelin, ai pret te vizitohet mesohet e shtohen. Presin te gjelbera e te padjegura, ne mes avujve te nxehte qe vijne nga puset me nafte te Kucoves. Drejtori i shkolles thote "se ato qe kemi arritur me mjedisin ku jetojme, duhet tua mesojme femijeve ne te gjithe nivelet e shkollave. Ka ardhur koha te futen oret e edukates se mjedisit. Mjafton te modifikohen lendet e edukates shtepiake, mesimit te punes apo metaleve, duke i dhene mundesi gjenerates se re qe perrallat me ujqr, te zevendesohen me realitete qe mesojne si mund te realizohen me kosto minimale permiresime radikale te jetes e mjedisit ku jetojme."